

BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK
N J O F T I M

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 53, njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, ditën e hënë, datë **23. 05. 2016, ora 17.00**, në sallën e Këshillit Bashkiak, me rendin e ditës si vijon:

1. P/Vendim: **“Për pagesën e kuotës së anëtarësisë së bashkisë së Tiranës në Shoqatën për “Autonomi Vendore””.**
1. P/Vendim: Për **“Krijimin e Këshillit Artistiko – Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”.**
3. P/Vendim: Për **“Miratimin në parim të dhënies në përdorim pa kundërshtim, të 100 m2 të pasurisë shesh, Akademisë së Shkencave”.**
4. P/Vendim: Për **“Kalimin në administrim për shoqërinë “Ujësjiellës – Kanalizime” Tiranë Sh.a”, të një sipërfaqeje trualli funksional me emërtimin “Shtabi i Repartit Ushtarak nr.8836”, me vendndodhje në Yzberisht, në pronësi të Bashkisë së Tiranës, për ndërtimin e një depoje uji”.**
5. P/Vendim: Për **“Përcaktimin e vlerës minimale dhe maksimale të qirasë sipas strukturave të apartamenteve dhe të vlerës minimale dhe maksimale të të ardhurave për përfituesit e Banesave Sociale me Qira, në kuadër të projektit “Ndërtimi i banesave me qëllim social” në zonën e Shkozës, ish Fonder Mek”.**
6. P/Vendim: Për **“Miratimin në parim të zgjidhjes së kontratave të qirasë të lidhura me shoqërinë “Mak Albania” shpk”.**
7. P/Vendim: Për **“Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 58 dt 30/12/2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016””.**
8. P/Vendim: Për **“Trajtimin me Bonus Strehimi të disa familjeve në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lire”.**
9. P/Vendim: **“Për kalimin e funksioneve të mirëmbajtjes së rrugëve rurale, ujitjes dhe kullimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, si dhe administrimit të Pyjeve e Kullotave pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”.**
10. P/Vendim: **“Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Njësisë Administrative të Tiranës”.**

11. P/Vendim: “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë së Tiranës”.
12. P/Vendim: “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve dhe Klubit Sportiv “Tirana””.
13. P/Vendim: “Për kalimin e disa pasurive në administrim të Tirana Parking”.
14. P/Vendim: “Për kalimin e Parkut të Madh të Liqenit Artificial Tiranë (asetet e ndodhura në të), Varrezat e Dëshmorëve, Sauk, Kopshti Zoologjik, nga Drejtoria e Përgjithshme Nr 1 e Punëtorëve të Qytetit në administrim të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, kalimin e Amfiteatrit të Parkut të Madh të Liqenit Artificial nga Ndërmarja e Dekorit në administrim të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit dhe kalimin e Lulishtes pranë Galerisë së Arteve Tiranë, nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit në administrim të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”.
15. P/Vendim: Për “Disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.59, datë 30.12.2015, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar)”.
16. P/Vendim: Për “Një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 49, datë 11.11.2015, për “Miratimin e kritereve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit, nënzoneve të destinuara për parkim në qytetin e Tiranës, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës””.
17. P/Vendim: “Për dhënien e ndihmës financiare për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga përmytjet për disa familje të Tiranës”.
18. P/Vendim: “Për dhënien e ndihmës financiare për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë për disa familje të Tiranës”.
19. P/Vendim: Për “Miratimin e numrit të punonjësve me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, Drejtorinë e Përgjithshme nr.2 të Punëtorëve të Qytetit dhe Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit”.
20. P/Vendim: “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”.
21. P/vendim: Për “Përcaktimin e linjave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në bashkinë e Tiranës, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja”.
22. P/Vendim: Për “Miratim dhënie ambienti në përdorim Organizatës Save the Children në Shqipëri, për periudhën 1 Qershor 2016- 31 Maj 2017, në realizim të Projektit “Mbrojtja dhe integrimi i fëmijëve në situatë rruge (Qendra ditore për fëmijët në situatë rruge””.

23. P/Vendim: Për “Miratimin e dhënies së ambientit në përdorim Organizatës Shoqërore të Përkrahjes së të Rinjve- ARSIS, për periudhën 1 Qershor 2016- 03 Mars 2017, me destinacion për qendër sociale, në zbatim të Projektit “Ngritja e shërbimeve për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi, neglizhimi, dhuna dhe shfrytëzimi në Tiranë” nëpërmjet vënies në punë të qendrës multidisiplinare në Njësinë Administrative nr.7”.
24. P/Vendim: “Miratimi i pagesës për PAK dhe Invalidët e Punës për periudhën 1-31 Maj 2016”
25. P/Vendim: Për “Propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1-31.5.2016”.
26. P/Vendim: Për “Themelimin dhe pjesëmarrjen e Bashkisë së Tiranës në shoqërinë aksionere “Eco Tirana” sh.a, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit”.